

LIGJI Nr. 04/L-083
PËR REGJISTRIMIN DHE EVIDENCËN E TË PAPUNËSUARVE DHE PUNËKËRKUESVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR REGJISTRIMIN
DHE EVIDENCËN E TË PAPUNËSUARVE DHE PUNËKËRKUESVE

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj rregullohen mënyrat, procedurat, kushtet e regjistrimit, evidentimit dhe çregjistrimit të të papunësuarve dhe punëkërkuesve që kërkojnë punë në Qendrën Rajonale të Punësimit përkatësisht Zyrën Komunale të Punësimit në territorin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, ky ligj rregullon ndërmjetësimin në punësim, orientimin profesional, veprimtaritë arsimore që synojnë rritjen e punësimit.

Neni 2
Përkufizimet

1.Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1.Të papunësuarit - janë të gjithë personat prej moshës tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç, të cilët janë të papunë (as të punësuar me pagë, as të vetëpunësuar) të cilët kërkojnë punë aktivisht dhe janë të gatshëm për punë;

1.2.Punëkërkuesit - janë të gjithë personat që kërkojnë punë duke përfshirë edhe personat që punojnë me orar të plotë apo gjysmë orari dhe personat që janë suspenduar përkohësisht nga puna;

1.3.Punëdhënësi - personi fizik ose juridik i cili i siguron punë të punësuarit dhe i paguan pagën për punën ose për shërbimet e kryera;

1.4.Kartela e të papunësuarit - është një dokument zyrtar i Zyrës së Punësimit përmes së cilës vërtetohet regjistrimi i një personi si punëkërkues në Zyrën përkatëse të Punësimit;

1.5.Aftësimi dhe riaftësimi profesional - është një aktivitet që synon të sigurojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime të nevojshme për performancë efikase brenda një profesioni apo një grupi profesionesh;

1.6.MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

1.7.DPP - Departamenti i Punës dhe Punësimit;

1.8.DivPP - Divizioni i Punës dhe Punësimit;

1.9.**QRP - Qendra Rajonale për Punësim** - Zyra të Punësimit në kuadër të cilave veprojnë Zyre komunale të Punësimit dhe për punën e tyre i raportojnë Divizionit të Punës dhe Punësimit.

1.10.**ZKP - Zyra Komunale të Punësimit** - Zyra të Punësimit të cilat për punën e tyre i raportojnë Qendrës Rajonale për Punësim.

1.11.Për Qendrat Rajonale për Punësim dhe Zyre Komunale të Punësimit, në tekstin e mëtejme të këtij ligji do të përdoret nocioni Zyrat e Punësimit.

Neni 3 Mbajtja e evidencës

1.Zyra e Punësimit mban evidenca për:

- 1.1. të papunësuarit;
- 1.2. punëkërkuessit;
- 1.3. këshillim dhe orientim profesional;
- 1.4. punëdhënësit të cilët shfrytëzojnë shërbimet e Zyrave të Punësimit.

Neni 4 Regjistrimi dhe Evidencat për të papunësuarit dhe punëkërkuessit

1.Regjistrimi dhe evidenca e të papunësuarve dhe punëkërkuessve, bëhet në Zyrat e Punësimit të menaxhuara dhe administruara nga Ministria.

2.Të papunësuarit dhe punëkërkuessit duhet të lajmërohen për regjistrim dhe evidencë në Zyrat e Punësimit sipas vendbanimit të tyre.

3.Për regjistrim dhe evidentim në Zyrat e Punësimit, të papunësuarit dhe punëkërkuessit duhet të lajmërohen personalisht dhe me vete të sjellin:

- 3.1. letërnjoftimin valid;
- 3.2. dëshmitë për përgatitjen shkollore; dhe
- 3.3. dëshmitë për trajnimet eventuale të kryera.

4.Shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi mund të regjistrohet si i papunë, nëse ka leje të qëndrimit në kohë të përkohshme ose të përhershme në Republikën e Kosovës.

5.Të papunësuarit dhe punëkërkuessit nuk mund të jenë në evidencë njëkohësisht, në dy apo më tepër Zyra të Punësimit.

6.Për ndërrimin e vendbanimit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh i papunësuar i obligohet që ta informojë ZP-në.

7.Evidencën për të papunësuarit dhe punëkërkuessit i mbajnë Zyrat e Punësimit, në kartela të veçanta dhe në bazën e të dhënave në mënyrë elektronike.

Neni 5

I papunësuar

1.Sipas këtij ligji, i papunësuar konsiderohet personi i cili:

- 1.1.nuk është i punësuar;
- 1.2.është në moshë pune mbi tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjet;
- 1.3.është i aftë për punë;
- 1.4.aktivisht kërkon punë;
- 1.5.është i evidentuar në Zyrat e Punësimit;
- 1.6.është shtetas i Republikës së Kosovës dhe jeton në Kosovë;
- 1.7.Për shtetasin e huaj i cili ka leje të qëndrimit në kohë të përkohshme ose të përhershme në Republikën e Kosovës;
- 1.8.nuk është nxënës dhe student i rregullt, në studimet themelore;
- 1.9.nuk është i pensionuar.

Neni 6

Kartela e papunësisë

1.Zyrat e Punësimit plotësojnë dhe mbajnë kartelë të papunësisë, për të papunësuarit dhe punëkërkuarit të cilët paraqiten për herë të parë në Zyrat e Punësimit.

2.Kartela e të papunësuarit dhe punëkërkuarit përmban:

- 2.1.të dhënat personale të të papunësuarit-punëkërkuarit;
- 2.2.kualifikimin profesional të të papunësuarit – punëkërkuarit;
- 2.3.aftësimin profesional të punëkërkuarit pas shkollimit;
- 2.4.riaftësimin profesional të punëkërkuarit;
- 2.5.gjendjen socio-materiale të punëkërkuarit;
- 2.6.statusin familjar të punëkërkuarit;
- 2.7.rekomandimin për ndërmjetësim në punësim të punëkërkuarit, si dhe
- 2.8.të dhëna të tjera të cilat janë me interes për punëkërkuarin dhe Zyrën e Punësimit.

3.Kartelat me të dhënat sipas paragrafit 2. të këtij neni, mbahen në statistikën e arkivit të Zyrës së Punësimit.

4.Krahas kartelës së papunësisë, Zyrat e Punësimit lëshojnë edhe kartelën personale evidencuese për të papunësuarit dhe punëkërkuarit, me qëllim të mbajtjes së evidencës së saktë lidhur me statusin e të papunësuarit dhe punëkërkuarit, me afate kohore të përcaktuara nga Zyra e Punësimit.

Neni 7

Lajmërimi në Zyrat e Punësimit

1. Të papunësuarit dhe punëkërkuessit lajmërohen në Zyrat e Punësimit për t'u informuar për mundësitë e punësimit, vendet e lira të punës, këshillimin për punësim, këshillime profesionale, këshillime për aftësim dhe riaftësim profesional dhe ndërmjetësim në punësim.
2. Në bazë të dokumenteve dhe deklaratës me shkrim të ofruara nga i papunësuari dhe punëkërkuessi të përcaktuara me këtë ligj, Zyrat e Punësimit regjistrojnë të papunësuarin dhe punëkërkuessin.
3. Të gjitha shërbimet të cilat i ofrojnë Zyrat e Punësimit janë pa pagesë.

Neni 8

Obligimet e Zyrave të Punësimit

1. Zyrat e Punësimit janë të obliguara që në bazë të të dhënave të grumbulluara nga punëdhënësit për nevojat e punësimit, ta njoftojë të papunësuarin dhe punëkërkuessin mbi mundësitë dhe kushtet për punësim.
2. Zyrat e Punësimit ofrojnë këto shërbime dhe angazhohen për:
 - 2.1. evidentimin e të papunëve dhe punëkërkuessve;
 - 2.2. këshillimin profesional për punësim dhe udhëzimin në karrierë;
 - 2.3. informimin mbi mundësitë e punësimit;
 - 2.4. përgatitjen dhe ndërmjetësimin në punësim;
 - 2.5. përkrahjen për vetëpunësim;
 - 2.6. informimin për mundësitë e aftësimit dhe riaftësim;
 - 2.7. harmonizimin e ofertës dhe kërkesës për vendet e lira të punës;
 - 2.8. ofrimin e ndihmës teknike dhe profesionale të të papunësuarve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve.
 - 2.9. Dhënien e deklaratës së papunësisë, e cila për kërkuessit dhe përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale të kategorisë së II-të do të shërbejë si marrëveshje në mes të Zyrës së Punësimit dhe të papunësuarit të regjistruar.
 - 2.10. Deklarata e papunësisë duhet të jetë e nënshkruar nga Zyra e Punësimit dhe personi i regjistruar si i papunësuar.
 - 2.11. Zyra e Punësimit në çdo kohë do të lëshojë deklaratën e papunësisë, për të gjithë të papunësuarit të cilëve do t'u nevojitet në procesin e ri-aplikimit për ndihmë sociale.

Neni 9

Obligimet e të papunësuarve dhe punëkërkuessve

1. I papunësuari obligohet të paraqitet në Zyrat e Punësimit, rregullisht çdo tre (3) muaj dhe në çdo thirrje të Zyrave të Punësimit, ku me atë rast duhet të prezantojë letërnjoftimin dhe kartelën personale të evidentimit.

2. I papunësuar, ka për obligim që të:

2.1.kërkojë punë aktivisht dhe t'i drejtohet drejtpërdrejt punëdhënësit për punësim;

2.2.përgatisë planin individual për punë, bashkërisht me Zyrat e Punësimit;

2.3.marrë pjesë në masat aktive të punësimit, në pajtueshmëri me ligjin dhe planin individual të punësimit;

2.4.mos refuzojë punësimin dhe aftësimin e ofruar adekuat sipas udhëzimit të Zyrave të Punësimit.

2.5. mos refuzoj nënshkrimin e deklaratës së papunësisë.

3.Punëkërkuesi obligohet të paraqitet në Zyrën e Punësimit, së paku dy herë në vit.

4.Të papunësuarit dhe punëkërkuesit që realizojnë të drejtat e përcaktuara me këtë ligj, janë të obliguar të lajmërojnë Zyrën e Punësimit për çdo ndryshim i cili ndikon në realizimin ose humbjen e të drejtës, më së voni në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ka pasuar ndryshimi.

Neni 10

Ndërprerja e mbajtjes në evidencë të të papunësuarve dhe punëkërkuesve

1.Zyrat e Punësimit ndërpresin mbajtjen e të papunësuarit në evidencë, nëse:

1.1.themelon marrëdhënie pune;

1.2.regjistron ndonjë biznes dhe realizon të ardhura mujore;

1.3.bëhet nxënës apo student i rregullt në studimet themelore;

1.4.plotëson kushtet për pensionim të parakohshëm apo pension invalidor në pajtim me ligjin;

1.5.refuzon të hyjë në ndonjë trajnim apo e ndërpret pa arsye atë;

1.6.është në paraburgim, apo fillon të mbajë burgun në kohëzgjatje mbi gjashtë (6) muaj;

1.7.nuk paraqitet në Zyrat të Punësimit dy (2) herë radhas mbi gjashtë (6) muaj;

1.8.është shtetas i huaj dhe i ndërpritet leja e qëndrimit të përkohshëm apo të përhershëm;

1.9.çregjistrohet nga evidenca;

1.10.vërtetohet se kryen punë pa kontratë.

2.Punëkërkuesit i ndërpritet mbajtja në evidencën e ZP-së, në këto raste:

2.1.nëse gjatë një viti kalendarik nuk paraqitet në Zyrat e Punësimit;

2.2.me kërkesën e tij;

2.3.në rastet e parapara në nën-paragrafët, 1.2, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8. të paragrafit 1. të këtij neni;

2.4.Punëkërkuesit të cilit i ndërpritet mbajtja në evidencë, mundet përsëri të hyjë në evidencë si punëkërkues, pas kalimit të afatit gjashtë (6) mujor, nga data e ndërprerjes.

Neni 11
Fshirja nga evidenca e të papunësuarve dhe punëkërkuessve

1. I papunësuar dhe punëkërkuess fshihet nga evidenca e të papunëve në Zyrat të Punësimit, nëse:

- 1.1.mbush moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;
- 1.2.bëhet plotësisht i paaftë për punë, në pajtim me ligjin;
- 1.3.në rast të vdekjes;
- 1.4.nuk lajmërohet në ZP-ë pa arsye dy paraqitje radhas mbi gjashtë (6) muaj;
- 1.5.refuzon ndërmjetësimin e ofruar për punësim që i ofron ZP-ja, që i përgjigjet përgatitjes profesionale;
- 1.6.refuzon trajnimin e ofruar nga ZP-ja, apo braktis trajnimin pa arsye;
- 1.7.vërtetohet se deklarata e dhënë për papunësinë është e pavërtetë;
- 1.8.nuk lajmërohet të punëdhënësi që është dërguar nga ZP-ja për ndërmjetësim në punësim, që i përgjigjet profesionit dhe shkathtësive të tij;
- 1.9.refuzon të sjellë dëshmi në ZP-ë mbi kërkimin aktiv të punës;
- 1.10.refuzon të vërtetojë planin individual për punësim, apo nuk i përmbahet planit individual;
- 1.11.refuzon apo me fajin e tij, braktis pjesëmarrjen në masën aktive të punësimit.

Neni 12
Ri-evidentimi

Të papunësuarit dhe punëkërkuess të cilët janë ndërprerë dhe fshirë nga evidenca, kanë të drejtë të ri regjistrohen përsëri në Zyrat e Punësimit si të papunë, pas pushimit të ndonjëres prej rrethanave të përcaktuara me dispozitat e nenin 10 dhe 11 të këtij ligji, pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muajsh, përkatësisht për punëkërkuessin dymbëdhjetë (12) muaj.

Neni 13
E drejta e qasjes në të dhënat personale

I papunësuar dhe punëkërkuess ka të drejtë të shikojë të dhënat personale të cilat mbahen për të në evidencën e Zyrave të Punësimit dhe të kërkojë korrigjimin e të dhënave, nëse eventualisht ka ndonjë gabim ose parregullsi.

Neni 14
Evidencat e posaçme

1.Përveç evidencës për të papunësuarit dhe punëkërkuess, në kuadër të Zyrave të Punësimit mbahen edhe evidenca për:

- 1.1.vendet e lira të punës;
- 1.2.shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi të cilët kërkojnë punë;

1.3.shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët janë në punë të përkohshme jashtë vendit me ndërmjetësimin e Zyrave të Punësimit.

Neni 15 **Evidenca për punëdhënësit**

1.Evidencat për punëdhënësit të cilët shfrytëzojnë shërbimet e Zyrave të Punësimit, udhëhiqen në bazë të paraqitjes së kërkesave të tyre lidhur me nevojat për punëtorë në bazë të identifikimit gjatë hulumtimit të tregut të punës;

2.Evidenca mbahet në kartelë të veçantë të punëdhënësit. Kartela përmban të dhëna për:

2.1. emrin e firmës së punëdhënësit;

2.2. selinë dhe adresën;

2.3. shifrën e veprimtarisë dhe llojin e veprimtarisë;

2.4. numrin e të punësuarve;

2.5. nevojat për punësim dhe llojin e shërbimeve, të cilat punëdhënësi dëshiron ti shfrytëzojë në Zyrat e Punësimit;

2.6 shënime të tjera të nevojshme për udhëheqjen e evidencës.

Neni 16 **Përgjegjësia disiplinore**

Shërbyesit Civil në Zyrat e Punësimit të cilët nuk e zbatojnë ose veprojnë në kundërshtim me këtë ligj, i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore konform legjislacionit në fuqi.

Neni 17 **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ministria, në afat prej gjashtë (6) muajsh, prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të tij.

Neni 18 **Shfuqizimi i akteve**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 19 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L - 083
06 prill 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-013-2012, datë 26.04.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.

